



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 447/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazić dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e paraqitur nga subjekti politik Nisma për Kosovën paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Nisma për Kosovën.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga subjekti politik Nisma për Kosovën, me të cilën pretendohet se KQZ me datë 26.06.2014 rreth orës 15.00 ka publikuar rezultatet e zgjedhjeve në faqen e saj zyrtare, ku sipas këtyre rezultateve Nisma për Kosovën ka 684 vota me kusht, kurse me datë 23.06.2014 QNR i ka dhënë CD me rezultate ku sipas atyre formularëve Nisma për Kosovën ka 998 vota me kusht, çka do thotë se ka mospërputhje të rezultateve mes të dhënave të QNR-së dhe KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të bëhet korrigjimi i rezultateve dhe të figurojn aq vota sa i ka marr Nisma, dhe për këtë si dëshmi ka bashkangjitur kopjet e formularëve të votave me kusht, gjithsejtë prej 185 formularëve.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri hetimin e fletëvotimeve të kontestuar gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga subjekti politik Nisma për Kosovën dhe në bazë të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij, ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të rezultateve të shpallura nga KQZ dhe materialit zgjedhor në QNR, për të cilat parashtruesi i ankesës pretendon se ka mospërputhje të rezultateve të Nismës.

Lidhur me ankesën në fjalë është konstatuar nga raporti përfundimtar i rezultateve nga QNR-ja se subjekti Nisma posedon 998 vota me çka dëshmohet nga rezultati përfundimtar i KQZ-së e jo siç pretendohet në ankesë se i njëjti subjekt i posedon 684 vota.

Rezultati për të cilin pretendon pala ankuese është rezultat i pjesshëm i cili rezultat është përdorur vetëm sa për të informuar KQZ-në në atë periudhë kohore kur është informuar por në asnjë mënyrë ai rezultat nuk mund të përdoret si rezultat përfundimtar.

Për më tepër nga shkresa e dorëzuar në PZAP në përgjigje nga KQZ-ja konstatohet se së shpejti do të publikohet në ueb faqe rezultati përfundimtar lidhur me votat me kusht.

Andaj PZAP në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 447/2014 më datën 30.06.2014



**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.